

Njësia Korrektuese

e Misionit të Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë



Njësia Korrektuese e Misionit të Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë

Njësia Korrektuese (NJK) e Misionit të Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë (EULEX) ka qenë **partner** i palëkundur i Shërbimit Korrektues të Kosovës (SHKK) për gati 14 vjet. Deri në vitin 2012, NJK-ja e EULEX-it kishte **mandat ekzekutiv**, duke i ofruar mbështetje operacionale zyrtarëve të SHKK-së për përcjellje të të burgosurve.

Monitoruesit e NJK të EULEX-it ishin gjithashtu të **bashkëvendosur** në disa nga institucionet korrektuese deri në vitin 2020. Sot, NJK e EULEX-it i mbështet përpjekjet e SHKK-së për të zhvilluar një **ekip profesional të drejtuesve të lartë** dhe për të ofruar rehabilitim të burgosurve në një mjedis të sigurt përmes **monitorimit, mentorimit dhe këshillimit**. Kjo është arritur falë **pranisë të rregullt dhe mobile të ekspertëve korrektues të EULEX-it** në 11 institucionet korrektuese në Kosovë dhe përmes **takimeve** të shumta me stafin e SHKK-së. Që nga viti 2021, EULEX-i është duke e mbështetur edhe Shërbimin Sprovues të Kosovës (SHSK).



Ditët e para të Njesisë Korrektuese të EULEX-it

Nga viti 2008 deri në vitin 2012, NJK-ja e EULEX-it kishte mandat ekzekutiv dhe ishte përgjegjëse për disa detyra, duke përfshirë transportin dhe përcjelljen e të burgosurve. Dhjetëra **ekspertë korrektues nga shumë vende të BE-së dhe vendeve të treta** me ekspertizë në disa fusha të ndryshme **u bashkëvendosën në disa institucione të SHKK-së**. Këta ekspertë të EULEX-it ofruan trajnime tejet të vlefshme **në vendin e punës**, **mentorim** efektiv dhe **këshillim** ditor të ekspertëve **për kolegët e tyre kosovarë**.



Numri i staft korrektues të EULEX-it ndër vite		
	Ndërkombëtar	Vendas
2008	49	49
2009	65	65
2010	66	66
2011	74	74
2012	62	62
2013	25	25
2014	13	13
2015	7	7
2016	7	7
2017	6	6
2018	5	5
2019	6	6
2020	7	7
2021	8	8
2022	5	5

në shumë fusha të SHKK-së, duke përfshirë administrimin e burgjeve, operacionet dhe menaxhimin e sigurisë, si dhe menaxhimin ekonomik. Ky angazhim ka krijuar kushte më të mira për SHKK-në që të punojë dhe të sigurojë trajtim të barabartë për të gjithë të burgosurit në bazë të nevojave të tyre dhe rrezikut që e paraqet secili prej këtyre individëve.


Deri në vitin 2011, NJK-ja e EULEX-it ka ndihmuar në zhvillimin e **kontrollit të perimetrit në Qendrën Korrektuese në Dubravë** përmes monitorimit, mentorimit dhe këshillimit. EULEX-i ishte gjithashtu përgjegjës për vlerësimin e standardeve të sigurisë së kësaj Qendre Korrektuese dhe ka dhënë **rekomandime për adresimin e mangësive të sigurisë** në këtë institucion.

Nga viti 2008 deri në vitin 2012, NJK-ja e EULEX-it përfshinte një **Grup të armatosur për përcjelljen e të Burgosurve (GPB)** të bashkëvendosur me Njësinë e SHKK-së për përcjelljen. Me përgjegjësitë e reja të dorëzuara nga UNMIK-u, EULEX-i ishte i vetmi

aktor me qasje në veri të Kosovës në një atmosferë të tensionuar politike. GPB-ja ishte e ndarë në dy njësi, njëra e stacionuar në Qendrën Korrektuese në Lipjan dhe tjetra në Qendrën Korrektuese në Dubravë. Roli kryesor i GPB-së ishte përcjellja e të burgosurve në Mitrovicën e Veriut, por gjithashtu shtrihej në të gjithë Kosovën sa herë që burimet vendase të përcjelljes nuk ishin në dispozicion. Pas vitit 2012, Policia e EULEX-it i mori përgjegjësitë e përcjelljes dhe gradualisht ia kaloi ato SHKK-së.

Nga viti 2010 deri në vitin 2018, NJK e EULEX-it ishte gjithashtu e angazhuar, përmes monitorimit, mentorimit dhe këshillimit, në **planifikimin dhe ndërtimin e qendrave të reja korrektuese** siç është Burgu i Sigurisë së Lartë në Podujevë, duke siguruar që të krijoheshin institucionet e reja për t'i përmbushur kriteret e nevojshme ndërsa në të njëjtën kohë duke mundur hapësira për aktivitete dhe rehabilitimin e të burgosurve.

Përgjatë viteve, aktivitetet e monitorimit, mentorimit dhe këshillimit të EULEX-it kontribuan në **profesionalizimin e SHKK-së**, i cili gradualisht po merrte përsipër përgjegjësi në rritje ndërsa EULEX-i po tërhiqej. Përgjatë viteve, SHKK është zhvilluar vazhdimisht për t'u bërë një **shërbim** i cili në përgjithësi është në përputhje me **Rregullat Standarde Minimale të OKB-së për Trajtimin e të Burgosurve dhe Rregullat Evropiane të Burgjeve**.



Roli i Njesisë Korrektuese të EULEX-it sot

NJK-ja e EULEX-it e mbështet SHKK-në në zhvillimin e një **ekipi profesional të drejtuesve të lartë** dhe në rritjen e kapacitetit të tij për të **parandaluar ndërhyrjen e panevojshme dhe trajtimin preferencial** të burgosurve përmes monitorimit, mentorimit dhe këshillimit. NJK-ja gjithashtu i këshillon SHKK-në dhe SHSK-në për **menaxhimin e të burgosurve të profilit të lartë dhe të radikalizuar** dhe e lehtëson bashkëpunimin ndërmjet SHSK-së dhe SHKK-së me qëllim të **përmirësimit të rehabilitimit dhe riintegrit** të burgosurve.

Aktualisht, aktivitetet e NJK-së së EULEX-it përfshijnë:

- **Vizita të rregullta në terren** në 11 institucionet korrektuese për të monitoruar **funkcionet ditore** të institucioneve të SHKK-së, duke përfshirë trajtimin e të burgosurve dhe të paraburgosurve
- **Këshilla** për drejtuesit e SHKK-së se si të adresohen çështjet strategjike
- Mbështetje për krijimin e **një sistemi të planifikimit të vuajtjes së dënimit** për të burgosurit bazuar në një vlerësim individual të **rrezikut dhe nevojave**
- Monitorimi i zbatimit të **planeve të vuajtjes së dënimit** për të dënuarit
- Ofrimi i **kurseve të trajnimit** (të renditura në detaje në faqen tjetër)
- **Kontakti me të burgosurit** (nëse kërkohet)
- Monitorimi i **shoqërimit spitalor** të burgosurve të profilit të lartë
- Mbështetje për SHKK-në në **funksionalizimin e mëtutjeshëm të katër institucioneve korrektuese** të ndërtuara në vitet e fundit (Burgu i Sigurisë së Lartë, Qendra e Paraburgimit në Prishtinë, Qendra e Paraburgimit në Gjilan, Qendra Edukative Korrektuese në Lipjan)
- Mbështetje për **stafin korrektues femëror dhe Shoqatën e Grave të SHKK-së**
- Pjesëmarrja aktive në **grupe punuese** të ndryshme, të cilat hartojnë akte nënligjore dhe strategji (p.sh. Grupi Punues i Ministrisë së Drejtësisë për Programet e Trajtimin dhe Rehabilitimit të Burgosurve, Grupi i Punës për Hartimin e Aktit Nënligjor për Rregulloren e Brendshme)

NJK-ja e EULEX-it gjithashtu monitoron nevojat konkrete të **grave** dhe të **miturve** si dhe të **grupeve më të cenushme** siç janë personat me probleme të shëndetit mendor, dhe ofron këshilla për SHKK-në, përmes rekomandimeve, kurseve të trajnimit dhe mentorimit, se si të adresohen më së miri nevojat specifike të tyre.



Arritjet kryesore

Ekspertë të shumtë korrektues **nga vendet e BE-së mentoruan dhe këshilluan stafin vendas të SHKK-së** në shumë fusha të punës së tyre të përditshme. Kjo kontribuoi në profesionalizimin e SHKK-së, i cili e mori përgjegjësinë e plotë për të gjitha detyrat pas përfundimit të mandatit ekzekutiv të NJK të EULEX-it.

Që nga viti 2008, NJK-ja e ka ndihmuar SHKK-në në **zhvillimin e**:

- Njesisë për Përcjellje të Burgosurve (2008–2012)
- Njesisë Ekonomike të SHKK-së (në proces)
- Njesisë së Inteligjencës të SHKK-së (në proces)
- Inspektoratin e Brendshëm të Ministrisë së Drejtësisë (në proces)
- Njesisë për Vlerësimin dhe Klasifikimin e të Burgosurve (në proces)

Në vitin 2018, EULEX-i së bashku me disa organizata joqeveritare të Kosovës, institucione vendase dhe organizata ndërkombëtare, e ndihmuar SHKK-në në krijimin e **“Shoqatës së Grave në Shërbimin Korrektues të Kosovës”**, qëllimi i së cilës është avancimi i pozitës së gruas brenda SHKK-së, t'i ndihmojë punonjëset femra që ta zhvillojnë karrierën e tyre dhe ta arrijnë potencialin e tyre të plotë.

Nga viti 2008, NJK-ja e EULEX-it është duke ofruar udhëzime dhe këshilla për institucionet e Kosovës për **harmonizimin e projektligjeve dhe Procedurave Standarde të Veprimit** me **standardet** më të mira evropiane dhe ndërkombëtare.

Ndër vite, NJK e EULEX-it e ka ndihmuar gjithashtu SHKK-në në zhvendosjen e fokusit nga aspektet kryesisht të lidhura me sigurinë drejt lehtësimit të **rehabilitimit** të burgosurve dhe **kthimit të tyre të suksesshëm në komunitetet e tyre**, si dhe në **parandalimin e përsëritjes së veprave penale**.

Në vitin 2021, EULEX-i e mbështeti SHKK-në në hartimin dhe zbatimin e një **fushate në media dhe media sociale** në mbarë Kosovën për ta informuar publikun për punën e SHKK-së dhe për të ndihmuar në forcimin e reputacionit të tij.



Kurse trajnimi dhe vizita studimore

Gjatë këtyre viteve, NJK e EULEX-it ka organizuar disa kurse trajnimi për më shumë se një mijë pjesëtarë të stafit të SHKK-së në:

- **Zhvillimin e kapaciteteve drejtuese** (Planifikimi Strategjik; Menaxhimi i Financave Publike, Kontabilitet dhe Kontroll; Auditim; Sistemi i Menaxhimit të Dosjeve)
- **Rritjen e sigurisë** (Negociatat në Incidentet e Krizave; Trajnim në Inteligjencë dhe Analizë; Siguria e Burgjeve dhe Vlerësimet e Rrezikut të Sigurisë)
- **Siguria, shëndeti dhe rehabilitimi i të burgosurve** (Vlerësimi dhe klasifikimi i të burgosurve; Intervistimi i të burgosurve; Planifikimi i vuajtjes së dënimit; Menaxhimi i të burgosurve me probleme të shëndetit mendor dhe varësisë; trajnimi bazë për reanimim dhe ndihmë të parë; Zbulimi i hershëm i ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizimit në burgje)
- **Integrimi gjinor dhe përfshirja gjinore**



NJK e EULEX-it gjithashtu organizoi **vizita studimore** për stafin e SHKK-së në **Finlandë** (2011, 2013, 2017 dhe 2019), **Estoni** (2013), **Mbretëri të Bashkuar** (2014) dhe **Suedi** (2017 dhe 2019).

Donacionet

Prej vitit 2008, NJK e EULEX-it e ka mbështetur SHKK-në edhe përmes disa **donacioneve**, duke përfshirë:

- 57 automjete
- 50 kompjuterë, pesë laptopë dhe 50 telefona celularë për të ndihmuar në rritjen e qasjes telefonike dhe virtuale për të burgosurit dhe për t'i lehtësuar takimet virtuale të stafit të shërbimit korrektues gjatë pandemisë COVID-19 (prill 2020).
- Pajisje të reja për furrën në Qendrën Korrektuese të Grave në Lipjan.
- Qëllimi i këtij donacioni të përbashkët EULEX-UNMIK ishte që të lehtësohet rehabilitimi i të burgosurve dhe t'i pajis ata me aftësi që do t'u ndihmonin atyre të punësohen pas lirimit të tyre (korrik 2021).



- Kompjuterë, UPS, rauterë, printera, radio, telefona celularë, GPS, dylbi, ndriçues dore dhe tavolina (shtator 2021)
- Materiale të nevojshme për të prodhuar karrige në Qendrën e Paraburgimit në Mitrovicë, si pjesë e programit të risocializimit të burgosurve (janar 2022).
- Komplete të ndihmës së parë, pajisje për trajnime dhe pajisje të TI-së për të gjitha qendrat e paraburgimit dhe atyre korrektuese në Kosovë për t'i ndihmuar instruktorët e SHKK-së për Reanimim që t'i organizojnë në mënyrë të pavarur aktivitetet trajnuese bazë për reanimim për kolegët e tyre (gusht 2022).

Rëndësia e bashkëpunimit ndërmjet Njesisë Korrektuese të EULEX-it, Shërbimit Korrektues të Kosovës dhe Shërbimit Sprovues të Kosovës

Për të arritur një sistem efektiv të burgjeve në aspektin social, i cili është në përputhje me Rregullat Evropiane të Burgjeve të Këshillit të Evropës dhe Rregullat Standarde Minimale të OKB-së për trajtimin e të burgosurve, bashkëpunimi i ngushtë ndërmjet SHKK-së, SHSK-së dhe EULEX-it është jashtëzakonisht i rëndësishëm.

Synimi ynë i përbashkët është që t'i forcojmë shërbimet korrektuese dhe ato sprovuese që të jenë në përputhje të plotë me standardet ndërkombëtare të drejtave të njeriut dhe qasjen e Këshillit të Evropës ndaj një sanksioni penal më njerëzor dhe efektiv nga aspekti social.

Përveç kësaj, EULEX-i i ndihmon të dyja institucionet në terren për zbatimin e praktikave më të mira evropiane për burgjet dhe shërbimin sprovues që kanë për synim riintegrimin dhe risocializimin më të mirë të mundshëm për të gjithë të burgosurit.





www.eulex-kosovo.eu

